



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 7579 Prot.

Tiranë, më 06.12. 2024

URDHËR

Nr. 593, datë 06.12. 2024

PËR

**PËR SHPALLJEN E VENDEVE VAKANTE PËR OFICERË SIGURIE NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PUBLIK**

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 600, datë 9.10.2018, Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, të ndryshuar, urdhrit nr. 589, datë 03.12.2024 “Për përcaktimin e institucioneve të arsimit parauniversitar të cilat kanë shërbimin e sigurisë publike”, si dhe urdhrit nr. 565, datë 5.10.2023, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit znj. Nina Guga”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurës së shpalljes së vendeve vakante për oficerë sigurie në institucionet e arsimit parauniversitar publik.
2. Kriteret, procedura e konkurrimit, mënyra dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit për pozicionet vakant për oficerë sigurie në institucionet e arsimit parauniversitar publik përcaktohen në shpalljen bashkëlidhur këtij urdhri, pjesë përbërëse e tij dhe publikohen në faqen zyrtare (web) të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Zyra e Koordinimit dhe Monitorimit dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTËR

NINA GUGA



SHPALLJE

PËR VENDE VAKANTE PËR OFICER SIGURIE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PUBLIK

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; vendimit nr. 600, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, të ndryshuar, Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 6068, datë 01.06.2018, ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”, dhe urdhrit nr. 541, datë 15.09.2022, “Për ngritjen e zyrës së koordinimit dhe monitorimit për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike””, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall procedurat për vende vakante për oficerë sigurie sipas zyrave vendore të arsimit parauniversitar, si më poshtë:

Nr.	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar	Numri i vendeve vakante për oficerë sigurie
1	Bulqizë	1
2	Dibër	3
3	Durrës	3
4	Kamëz	3
5	Kavajë	2
6	Krujë	5
7	Shijak	1
8	Tiranë	15
9	Divjakë	1
10	Fier	1
11	Gjirokastër -Libohovë	2
12	Përmet - Këlcyrë	2
13	Sarandë - Delvinë - Konispol	3
14	Vlorë - Himarë	3
15	Berat	2
16	Kuçovë	2
17	Librazhd	1
18	Poliçan	1
19	Skrapar	1
20	Kukës	1
21	Lezhë	5
22	Pukë - Fushë Arrëz	1
23	Shkodër	1
24	Tropojë	1
25	Elbasan	1

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I POZICIONI TË OFICERIT TË SIGURISË

Siguria në shkollë është një element thelbësor i parandalimit të dukurive negative, si brenda edhe jashtë mjediseve të shkollës. Lufta kundër dukurive të tilla si: episode të dhunës, përdorimi i drogave dhe substancave abuzive, dukuria e bullizmit, siguria fizike në shkolla etj., janë prioritet i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe i Ministrisë së Brendshme.

Menaxhimi i sigurisë në shkolla kërkon një ndërveprim të vazhdueshëm me nxënësit dhe stafin e shkollës, gjë të cilën merr përsipër të realizojë oficeri i policisë në shkolla. Për këtë arsye, duke synuar rritjen e sigurisë nëpërmjet ndërveprimit dhe parandalimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme nëpërmjet marrëveshjes së firmosur midis palëve, kërkon të krijojë një qasje të re nëpërmjet krijimit të rolit të oficerit të sigurisë në shkollë. Ky pozicion pune në shkollë, merr rol të rëndësishëm për krijimin e një mjedisi të sigurt, përmes ndërtimit të marrëdhënieve të forta e të qëndrueshme me nxënësit, stafin e shkollës, prindërit dhe komunitetin.

2. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

Oficeri i sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar publik ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Monitoron mjedisin e shkollës në mënyrë të vazhdueshme, rreth situatave të dyshimta, hyrjes së personave të paautorizuar apo cenimit të pronës së shkollës.
- Ofron një prani të dukshme dhe të aksesueshme brenda shkollave dhe më gjerë në komunitet.
- Punon me shkollat për përmirësimin e nivelit të ndërgjegjësimit për problematika si: përdorimi i drogës, bullizmi, siguria në internet, pasoja e dhunës dhe krimit.
- Parandalon dhe menaxhon rastet emergjente dhe të dhunës në shkollë.
- Kontribuon në ndërgjegjësimin e nxënësve për rregullat, ligjin dhe drejtësinë.
- Merr pjesë në takimet me prindër dhe në takime periodike të stafit pedagogjik të shkollës për evidentimin e problematikave dhe diskutimin e zgjidhjeve për sigurinë në shkollë, sa herë kërkohet nga drejtori i shkollës.
- Bashkëpunon me drejtorinë e shkollës dhe stafin pedagogjik, për të garantuar dhe krijuar një mjedis të sigurt në shkollë.
- Ndërvepron me drejtorinë e shkollës dhe me stafin e saj duke ndërhyrë dhe parandaluar në rastet e thyerjes së disiplinës, menaxhimit të krizave dhe në rastet e emergjencave.
- Krijon një plan sigurie të shkollës, duke përcaktuar risqet e mundshme, daljet emergjente dhe duke minimizuar burimet e aksidenteve.
- Bashkëpunon me agjencitë ligj zbatuese dhe shërben si ndërlidhës mes Policisë së Shtetit dhe komunitetit, me qëllim parandalimin e veprave kriminale.

- Evidenton situatat e parregullta të rendit dhe të sigurisë publike, brenda dhe jashtë perimetrit të shkollës, dhe njofton oficerin e policimit në komunitet.
- Shërben si oficer raportues dhe menaxhues, i situatave, të cilat mund të paraqesin një rrezikshmëri në mjediset e shkollës.
- Bashkëpunon dhe ndërmjetëson me punonjësin e shërbimit psiko-social në situata konfliktuale brenda mjediseve të shkollës.
- Ofron prindërve asistencë për zgjidhjen e situatave të ndryshme dhe për menaxhimin e konflikteve.
- Përshtatet me komunitetin e zonës në të cilën ndodhet shkolla ku do të ushtrojë veprimtarinë ku do të veprojë.
- Realizon takime informuese me nxënësit, stafin pedagogjik dhe prindërit, për rastet që paraqesin rrezikshmëri shoqërore, me qëllim që të rris ndërgjegjësimin qytetar.
- Harton raporte javore, vjetore dhe të situatës/incidentit.
- Raporton në mënyrë periodike pranë autoriteteve përgjegjëse (Njësive Arsimore Vendore, Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit), sipas formateve të miratuara të raportimit.
- Zbaton parimet etike për ruajtjen e konfidencialitetit të rasteve të veçanta dhe sensitive.
- Zhvillon kontrolle fizike të nxënësve ose të mjediseve, vetëm në raste emergjente ose me vendim nga drejtoria e shkollave.

3. KRITERET E PRANIMIT

3.1 Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
 - b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;
 - d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
 - e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepër penale;
 - f) Të mos ketë marrë disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë.
- e) Të mos jetë në kushtet e nenit 60/1, të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3.2 Kriteria të veçanta

Kandidati duhet të ketë diplomë të ciklit të dytë ose diplomë të barasvlershme me të në fushën e edukimit, të shkencave sociale, sociologjisë, psikologjisë dhe të drejtësisë.

4. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- a. Kërkesë me shkrim për punësim ku përcakton Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, ku dëshiron të shërbejë **(i detyrueshëm)**;
- b. Jetëshkrim i plotësuar (CV-Curriculum Vitae) në përputhje me formatin Europass (adresa e e-mail është e detyrueshme), **(i detyrueshëm)**;
- c. Fotokopje të noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe

institucione të tjera të autorizuar, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet Vërtetimi i Njohjes dhe Njehsimit të Diplomës/Certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse **(i detyrueshëm)**;

- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (ID), **(i detyrueshëm)**;
- f. Vërtetim mjeko-ligjor, **(i detyrueshëm)**;
- g. Vërtetim të gjendjes gjyqësore **(i detyrueshëm)**;
- h. Vërtetim i lëshuar nga gjykata **(i detyrueshëm)**;
- i. Vërtetim i lëshuar nga prokuroria **(i detyrueshëm)**;
- j. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- k. Vlerësime dhe rekomandime nga punëmarrësi i mëparshëm (nëse ka);
- l. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës 2.

Dorëzimi i dokumenteve si më sipër, do të bëhet brenda datës **18.12.2024** në një nga këto mënyra:

- b) Me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- c) Dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

5. FAZAT E KONKURRIMIT

5.1 Verifikimi paraprak i dokumentacionit do të kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nga data 19.12.2024 deri më datë 23.12.2024.

Në fazën e verifikimit paraprak do të kryhet kontrolli i dokumentacionit të kërkuar në pikën 4 të kësaj shpalljeje. Pas verifikimit të dokumentacionit publikohet lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret sipas pikës 3, të shpalljes të cilët do të vazhdojnë në fazën vijuese. Kandidatët e kualifikuar për të vazhduar fazat e mëtejshme të konkurrimit dhe kandidatët e s'kualifikuar, do njoftohen në adresën e email të deklaruar në CV, brenda datës **24.12.2024**.

Ministria e Arsimit dhe Sportit pas njoftimit të kandidatëve të kualifikuar/s'kualifikuar do të pranojë ankimimet brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit.

Ankimi duhet të depozitohet në adresën elektronike: oficere-sigurie@arsimi.gov.al. Në përfundim të shqyrtimit të ankimeve, në datën **27.12.2024**, në faqen zyrtare (ëeb) të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit shpallet lista përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar dhe afati i intervistës.

5.2 Intervista gjysmë e strukturuar¹ (sipas formatit të shtojcës 3) do të zhvillohet në datat e publikuara në faqen zyrtare (ëeb) të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

a) Komisioni i intervistimit do të ketë 5 anëtarë, me këtë përbërje:

- Dy nga Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Dy nga Ministria e Brendshme

¹ Intervista gjysmë e strukturuar është ndërtuar nga një grup pyetjesh paraprake, por që (e cila) është e hapur, duke lejuar që ide të reja të ngrihen gjatë intervistës si rezultat e asaj që intervistuesi thotë.

- Një nga Urdhri i Psikologut.

b) Intervista do të kryhet rreth legjislacionit të mëposhtëm:

Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Manuali për Policimin në Komunitet;
- Broshurat informuese (për mësues, prindër dhe nxënës) rreth rolit të Oficerit të Sigurisë në Shkolla.
- Kodi i Etikës i Mësuesve në Arsimin Parauniversitar Publik dhe Privat.

c) Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Intervista strukturuar me gojë vlerësohet me 50 pikë maksimumi.

6. SHPALLJA E LISTËS SË KANDIDATËVE TË KUALIFIKUAR

- Zyra e Koordinimit dhe Monitorimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, do të shpallë listën përfundimtare të të kualifikuarve në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit 2 ditë kalendrike pas përfundimit të intervistës.
- Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet.
- Lista e kandidatëve të kualifikuar i përcillet Akademisë së Sigurisë për trajnimin dhe certifikimin e tyre brenda 2 ditëve kalendrike.

7. TRAJNIMI DHE CERTIFIKIMI NGA AKADEMIA E SIGURISË

Kandidatët e kualifikuar nga intervista i nënshtrohen trajnimit 1-mujor nga Akademia e Sigurisë. Kandidatët që ndjekin trajnimin i nënshtrohen testimit.

Testimi me shkrim vlerësohet me 50 pikë maksimumi.

Të gjithë kandidatët që kalojnë me sukses testimin certifikohen nga Akademia e Sigurisë.

Lista e kandidatëve që përfundojnë me sukses këtë testim i përcillet zyrtarisht Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ministria e Arsimit dhe Sportit harton listën përfundimtare (pikët e testit + pikët e intervistës) sipas rendit zbritës.

SHTOJCA 1

VENDET VAKANTE PËR OFICERË SIGURIE

Nr.	ZVAP	Institucioni Arsimor	Vendodhja
1	Bulqizë	Asllan Keta	Fushë Bulqizë
2	Dibër	Selim Alliu	Peshkopi
3	Dibër	Said Najdeni	Peshkopi
4	Dibër	Gjergj Kastrioti	Kastriot
5	Durrës	Olsi Lasko	Durrës
6	Durrës	Dhosi Liperi	Durrës
7	Durrës	Shaqe Mazrreku	Durrës
8	Kamëz	Jashar Hoxha	Paskuqan
9	Kamëz	Ahmet Zogu	Bathore
10	Kamëz	Ibrahim Basha	Bathore
11	Kavajë	Gjimnazi Luzi Vogel	Luz i Vogël
12	Kavajë	11 Shkurti	Synej
13	Klos	Shaban Çollaku	Klos
14	Krujë	Shote Galica	Fushë - Krujë
15	Krujë	Gjergj Kastrioti Skënderbeu	Krujë
16	Krujë	Ramazan Karaj`	Nikël
17	Krujë	Ramazan Jangozi	Thumanë
18	Krujë	Haxhi Qira	Burizanë
19	Shijak	16 Shtatori	Shijak
20	Tiranë	Isa Boletini	Paskuqan
21	Tiranë	Loro Boriçi	Tiranë
22	Tiranë	Mustafa Kemal Ataturk	Zall-Herr
23	Tiranë	Ismail Qemali	Tiranë
24	Tiranë	Andrea Stefani	Tiranë
25	Tiranë	Androkli Kostallari	Tiranë
26	Tiranë	Hasan Tahsin	Tiranë
27	Tiranë	Klodian Tanushi	Tiranë
28	Tiranë	Naim Frashëri	Tiranë
29	Tiranë	Sabaudin Gabrani	Tiranë
30	Tiranë	Luan Hajdaraga	Tiranë
31	Tiranë	Kristo Frashëri	Tiranë
32	Tiranë	John F. Kenedy	Tiranë
33	Tiranë	Sevasti Qiriazhi	Tiranë
34	Tiranë	Qemal Cena	Kashar
35	Divjakë	Grabian	Grabian
36	Fier	Gjimnazi me kohe te pjesshme"	Fier
37	Gjirokastër-Libohovë	Siri Shapllo	Gjirokastër
38	Gjirokaster-Libohovë	Koto Hoxhi	Gjirokastër

39	Përmet	Seifulla Maleshova	Këlcyrë
40	Sarandë - Delvinë - Konispol	5 Dëshmorët	Ksamil
41	Sarandë - Delvinë - Konispol	Adem Sheme	Sarandë
42	Sarandë - Delvinë - Konispol	Bido Sejko	Konispol
43	Vlorë - Himarë	Mustafa Qemal Ataturku	Vlorë
44	Vlorë - Himarë	Lef Sallata	Vlorë
45	Vlorë - Himarë	Rilindja	Vlorë
46	Berat	Gjimnazi me kohe te pjesshme	Berat
47	Berat	Lapardha	Otlak
48	Elbasan	Luigj Gurakuqi	Elbasan
49	Kuçovë	Aleksandër Markaçini	Kozare
50	Kuçovë	Myrteza Kepi	Perondi
51	Librazhd	Ibrahim Muça	Librazhd
52	Polican	Mbrakull	Vërtop
53	Skrapar	Ramiz Aranitasi	Skrapar
54	Kukës	Bushtricë	Bushtricë
55	Lezhë	Hydajet Lezha	Lezhë
56	Lezhë	Besëlidhja	Lezhë
57	Lezhë	Gjergj Kastrioti	Lezhë
58	Lezhë	Llesh Nik Daka	Shënkoll
59	Lezhë	Ndoc Gjetja	Shëngjin
60	Pukë - Fushë Arrëz	Fushë - Arrëz	Fushë - Arrëz
61	Shkodër	Kolë Idromeno	Shkodër
62	Tropojë	Asim Vokshi	Bajram Curri

SHTOJCA 2

DEKLARATË PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTAVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë..... kandidat në procesin e konkurrimit për oficer sigurie në DRAP/ZVAP, të zhvilluar në vitin shkollor 2024-2025, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ministrinë e Brendshme të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

AUTORIZUESI _____

SHTOJCA 3

FORMATI I INTERVISTËS GJYSMË TË STRUKTURUAR

Shembuj pyetjesh:

- Cili është formimi juaj akademik? Pse e zgjodhët këtë degë? A jeni ndjerë të kënaqur nga zgjedhja juaj? Nëse do t'ju jepej mundësi të rizgjidhnit edhe një herë, do të bënit përsëri të njëjtën zgjedhje?
- Cili është roli i Oficerit të Sigurisë në shkollë? Cilat nga detyrat/përgjegjësitë kryesore ju duket e vështirë për tu arritur? Mendoni se ka detyra/përgjegjësi të tjera që mund t'i bëjë Oficeri i Sigurisë dhe nuk janë shprehur në përshkrimin e punës? Ju do donit të shtonit të tjera?
- A mendoni se jeni ju kandidat potencial për këtë pozicion? Çfarë risie do të sillnit ju në shkollën që do të kryenit detyrën? Cila mendoni se do ishte vështirësia që do të hasnit në ushtrimin e detyrës, duke pasur parasysh kontekstin e zonës?
- Cili do të jetë përfitimi i nxënësve nga prezenca juaj në shkollë? Çfarë dini ju për karakteristikat kryesore të tyre që shoqërojnë këtë stad të zhvillimit (adoleshencën)?
- Çfarë do të jepni nga vetja në shkollën ku do të punoni? Çfarë mendoni për stafin akademik dhe si mund të bashkëpunoni me ata? Po bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin?
 - A keni ndonjë mendim tjetër në lidhje me këto çështje? Keni gjë tjetër për të shtuar, apo diçka që ju kujtua tani dhe nuk e keni përmendur më sipër?